



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL  
DREJTORIA E AERODROMEVE

Nr. 2916 prot.

Tiranë, më 10.12.2024

VENDIM

Nr. 153, datë 10.12.2024

PËR

**DISA NDRYSHIME NË MJETET E PËRPUTHSHMËRISË (AMC) DHE  
MATERIALET UDHËZUESE (GM) PËR AERODROMET, TË PRANUARA ME  
VENDIMIN NR. 100, DATË 11.09.2024, PËR ZBATIMIN E URDHRI TË  
MINISTRIT TË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË NR. 170, DATË 13.09.2022**

Në mbështetje të Nenit 14, pika (ë), të Ligjit Nr. 53/2022 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil”, në zbatim të pikës ADR.AR.A.015, të Aneksit 2, të Urdhrit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 170, datë 13.09.2022 “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e kërkesave dhe procedurave administrative që lidhen me aerodromet në Republikën e Shqipërisë”,

**V E N D O S A:**

1. Në AMC dhe GM të EASA, lëshimi 1, amendimi 7 dhe 8 për zbatimin e Rregullores së Komisionit (BE) NR 139/2014 të 12 Shkurt 2014, pranuar me Vendimin Nr.100, datë 11.09.2024, paragrafët si më poshtë:
  - a) GM1 ADR.OPS.A.005 Aerodrome data/ strength of pavements;
  - b) GM1 ADR.OPS.C.010(b)(1) Pavements, other ground surfaces, and drainage overload operations;
  - c) AMC3 ADR.OR.E.005 Aerodrome manual, Part D— particulars of the aerodrome required to be reported to the Aeronautical Information Service, pika 5 dhe 6;

nuk do të përdoren si udhëzues për të demonstruar përputhshmërinë me parashikimet përkatëse të Urdhrit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 170, datë 13.09.2022.

2. Lidhur me metodologjinë e përdorur për raportimin e fortësisë së sipërfaqeve të shtruara do të zbatohen parashikimet e Urdhrit të Ministrit Nr. 282, datë 11.11.2024 për disa shtesa në Urdhrin e Ministrit nr. 170, datë 13.9.2022, “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e kërkesave dhe procedurave administrative, që lidhen me aerodromet në Republikën e Shqipërisë”.

3. Ngarkohet Drejtoria e Aerodromeve për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi dhe publikimin dhe njoftimin e tij tek operatorët e aerodromeve.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**DREJTOR EKZEKUTIV**

**Maksim Et'hemaj**

